



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:270261

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730789

K.DH.SH.II.nr.1529/23

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.P “Yess Pharma” me numër të regjistrimit të biznesit 80060319, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Agron Selimaj, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Erleta Popaj, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.24/22 të datës 23.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditësit N.T.P “Yess Pharma” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.24/22 të datës 23.05.2023, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.24/22 të datës 23.05.2023, me aktgjykimin e atakuar nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, ka vendosur, Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P “Yess Pharma” me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit PSH.nr.226, 227/18 të datës 16.07.2018 të nxjerr nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit. Nën pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit së autorizuar, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative/kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të Dhoma e Shkallës së Dytë të merr aktgjykim me të cilin aprovohet ankesa e paditësit “Yess Pharma” dhe të prishet aktgjykimi KA.nr.24/2023 i datës 23.05.2023 dhe çështja të kthehet në rigjykim në Dhomën e Shkallës së Parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Panelit Shqyrtues të Prokurimit Publik, PSH.nr.226, 227/18 të datës 16.07.2018, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, janë aprovuar si pjesërisht e bazuar ankesat e operatorëve ekonomik OE “Yess Pharma” dhe OE ankues: “Medical Group”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me materiale Specifik për Kardiologjinë Invazive”, Lot 1 dhe 6, si dhe Lot 3,4,5 me numër të prokurimit: 206-18-636-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Shëndetësisë. Nën pikën II, Vërtetohet njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me materiale Specifik për Kardiologjinë Invazive”, Lot 1 dhe 6, si dhe Lot 3,4,5 me numër të prokurimit: 206-18-636-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Shëndetësisë. Nën pikën III, Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nën pikën IV. Mosrespektimi i këtij venimi, detyron Panelin

Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Nën pikën V. Meqenëse ankesa e operatorëve ekonomik ankues: “Yess Pharma” dhe OE ankues “Medical Group” Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara iu kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Ndërsa nën pikën VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 17.08.2018, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur paditësit i ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën kundër vendimit të autoritetit kontraktues, ashtu që e ka vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës me titull “Furnizim me Material Specifik për Kardiologjinë Invazive” Lot 1 dhe 6 si dhe Lot 3,4,5 të iniciuar nga AK Ministria e Shëndetësisë, për arsye se OE të rekomanduar kanë plotësuar dokumentet në procedurën para Autoritetit Kontraktues gjë e cila është e lejueshme përderisa nuk shkaktojnë ndryshime materiale. Për të vërtetuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua nenit 59 par.4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, andaj duke pasur parasysh se OE të rekomanduar janë paraqitur certifikatat e tyre gjatë procedurës pranë Autoritetit Kontraktues dhe ky është konsideruar si një devijim i vogël, gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë duke lënë në fuqi vendimene Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material specifik për kardiologjinë invazive”, pasi që në shkresat e ofertës kanë qenë të bashkngjitura certifikatat me afat dhe të cilat i kanë plotësuar kërkesat për aftësin teknike e profesionale të ofertës dhe plotësimi i këtij dokumentacioni mund të trajtohet si devijim i vogël dhe nuk ka shkakuar ndryshime material kjo duke u bazuar edhe në faktin se certifikata e dorëzuar më vonë ka pasur datën e fiksimit para ditës së fundit për dorëzimin e ofertave. Gjykata gjithashtu shqyrtoi pretendimet e përfaqësuesit

të paditësit lidhur me ekspertizën financiare të hartuar nga eksperti i prokurimit publik që vërteton pretendimet e tij, por gjykata konstaton se përkundër që eksperti rekomandon aprovimin e pjesëshëm të ankesës së paditësit, në përmbajtje të ekspertizës konstaton se OE e rekomanduar për kontratë plotësojnë kriteret e përcaktuara në dosjete tenderit, andaj gjykata nuk gjeti prova tjera përmes të cilave do të vërtetohej një gjendje faktike ndryshe prej asaj të cilë e ka kontestuar i padituri. Gjkata përfundimisht vlerëson se i padituri me vendimin kontestues në procedurë administrative ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, andaj kërkesëpadia e paditësit rezulton të jetë e pa bazuar.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitave ligjore nga neni 59 par.4 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik. Sepse me nenin Në nenin 59 par.4 është përcaktuar se *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”*.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se aktgjykimi është kundërthënës në mes të pjesës së dispozitivit dhe arsyetimit sidomos në pjesën e fakteve vendimtare-mungesën e certifikatave CE dhe ISO, mungesën e tyre e ka konstatuar edhe

eksperti shqyrtues, dhe për shkak të skadimit të afatit të këtyre certifikatave të prezntuar nga tenderuesi fitues, ka propozuar rivlerësim të tenderti, kurse afatshmëria e tyre është kontestuar edhe nga vet e paditura. Dhoma e Shkallës së parë ka ardhur deri tek konstatimi jo i plotë i gjendjes faktike, me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë i është referua nenit 69 par.1 nëqë të cilën është përcaktuar se *“Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen”*. Prandaj edhe plotësimet e bëra pranë Autoritetit Kontraktues duke e oplotësuar dosjen me certifikata të reja të afatshme janë bërë në përputhje me nenin 59 par.4 dhe 69 par.1 të LPP-së. Andaj, për këtë arsye Dhoma e Shkallës i vlerësoi si të pa bazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat nuk kanë gjetur mbështetje në dispozitat ligjore materiale të cilat rregullojnë këtë çështje dhe nuk kanë qenë në përputhje me provat e administruara për të vendosur ndryshe në këtë çështje administrative.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës administrative/kontestimore, për shkak se aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, pasi që i njëjti është kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin, respektivisht arsyet e theksuara në të janë të pa qarta dhe kundërthënëse me faktet, respektivisht provat e paraqitura nga paditësi. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhoma e Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji i vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë të paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme

një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

K.DH.SH.II.nr.1529/23, me datë 24.05.2024

**Kryetare e kolegjit,  
Saranda Bogaj Sheremeti**